

DEKRET
Nr. 439, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e dekoratës “Ylli i Madh i Urdhrit të Skënderbeut” zotit Seit Mansaku

“Në vlerësim të kontributeve krejt të veçanta e të meritave jashtë të zakonshmes në përparimin shkencor të mirëfilltë të kërkimeve historike dhe filologjike në fushë të shqipes, me rezultate të spikatura në lëmin e onomastikës, por jo vetëm, të cilat shpalosin erudicion, përvojë profesionale, integritet dhe qartësi të lavdërueshme që nderojnë një punë shumëvjeçare jashtë zhurmës së përditshmërisë, por shumë fisnike dhe themelore për ruajtjen e standardeve më të larta akademike në fushën e gjuhësisë”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj